



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 05 gusht 2020, në mbledhjen e XXV-të (njëzet e pesë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;05.

Në mungesë të Kryesueses së komitetit, mbledhjen e hapi dhe kryesoi Valbone Kadriu – Podvorica zëvendës kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu ndërsa munguan Albina Avdiu, Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, përfaqësues nga Policia e Kosovës (Stacioni Podujevë)

Rendi i ditës

znj.Valbone Kadriu - Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje dhe duke i njoftuar për mungesën e Kryesueses së Komitetit për Komunitete znj.Albina Avdiu për të cilën tha se përmes telefonit më ka njoftuar se nuk mund të jetë prezentë sot në mbledhje për shkak të punëve dhe angazhimeve personale. Ndër të tjera shtoi, konstatoj që janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, besoj që materialin e keni marrë me kohë dhe jeni në njohuri për pikat e rendit të ditës. Nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

- 1. Identifikimi i nxënësve të komuniteteve jo shumicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor, respektivisht procesin mësimor jo formal për përfundimin e klasave përkatëse.**

znj.Doruntina Hasani, theksoi, fillimisht do t'kishte qenë më mirë që informacionet t'i kishim nga Drejtoria e Arsimit, në fakt ne kemi pasë tash së fundmi dy pika të rendit të ditës rreth këtyre çështjeve dhe kemi marrë disa informata nga Drejtoria e Arsimit mirëpo jo rreth nxënësve të Komuniteteve jo shumicë të cilët eventualisht kanë ndërprerë mësimin, kështu që do të ishte më se nevojshme që ne si Komiteti për Komunitete të kemi një bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje për ata nxënës, të bashkëbisedojmë me ata nxënës dhe familje të tyre me qëllim që t'i dimë arsyet e ndërprerjes së shkollimit.

z.Bashkim Syla, theksoi, mendoj që identifikimi i atyre nxënësve që eventualisht kanë ndërprerë shkollimin veç ekziston sepse drejtorët e shkollave dhe kujdestarët e klasave i kanë informatat se cilët nxënës kanë ndërprerë mësimin, nëse veç ka të tillë, por vetëm duhet të ketë një linjë zyrtare të komunikimit mes Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorëve të shkollave. Pra mendoj që drejtorët e shkollave dhe kujdestarët e klasave i kanë ato të dhëna, numrin e tyre dhe eventualisht shkakët apo arsytet e ndërprerjes.

Mirëpo tani jemi në gjendje të pandemisë dhe mendoj se është paksa e vështirë të merremi në këtë kohë me këtë problematikë përderisa mësimi zhvillohet në distancë për të gjithë, kështu që ndoshta edhe Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim ka informata më shumë rreth kësaj çështje, mirëpo parapseprap do të ishte mirë që diskutimi rreth kësaj teme të zhvillohej në prezencë të ndonjë zyrtari të Drejtorisë së Arsimit ngase ne më shumë se kaq nuk kemi informata.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kolegu parafolës e tha se kjo kohë nuk është e përshtatshme të merremi me këtë temë, mirëpo unë mendoj se bashkë kjo kohë është shumë e përshtatshme të merremi me këtë çështje për shkak se nëse ne i lejojmë nxënësit kështu të ndërpresin procesin mësimor nuk është gjë e mirë, por duhet një angazhim më i madh edhe i stafit të Drejtorisë së Arsimit e cila në bazë të cikleve të procesit arsimor do të duhej të merrej më shumë mirëpo ne patëm rastin të shohim informatën e kësaj Drejtorie edhe në Kuvendin e Komunës ku nuk pati ndonjë informacion as për nxënësit e komunitetit shumicë sepse nuk kanë informacione të sakta ende se sa përqind është zhvilluar mësimi, përveç disa informatave të përgjithshme që i kanë dhënë në nivelin qendror, por jo diçka konkrete për nivelin lokal, saktësisht për nxënësit që mungojnë ose ne duhet të identifikojmë ata nxënës sepse me gjasë procesi mësimor në shtator do të filloj sërish online si dhe për ata të cilët nuk kanë pajisje ose të bëjmë një plan ose të ndërmarrim edhe ne diçka qoftë këtu qoftë në Kuvendin e Komunës në mënyrë që të mundohemi t'i jua sigurojmë pajisjet e nevojshme.

z.Bashkim Syla, theksoi, ne këtu si Komiteti për Komunitete mendoj që pa prezencën dhe informacionin e Drejtorisë së Arsimit nuk di si mund të merremi me këto probleme, aq më shumë kur tani procesi mësimor është në pushim, mirëpo identifikimin e atyre nxënësve drejtorët e shkollave dhe kujdestarët e klasave e kanë besoj. Pastaj po nëse edhe ne vendosim të shkojmë të bisedojmë me ata nxënës dhe prindër të tyre prapseprap duhet të shkojmë përmes përfaqësuesve të lagjeve të tyre, kështu që pa qenë këtu prezent dikush prej Drejtorisë së Arsimit, mund të debatojmë sa të dëshironi por vetëm mbetet këtu si bisedë.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK-së, theksoi, nuk kam çfarë të shtoj diçka më shumë se sa që u tha nga parafolësit me të cilët pajtoj që duhet të jetë prezent këtu zyrtari i Drejtorisë së Arsimit i cili merret me statistikë. Po ashtu është shumë e saktë ajo që u tha nga parafolësi z.Bashkim Syl a që drejtorët e shkollave janë në dijeni se ku gjenden nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe shkollat ku vijojnë mësimet komuniteti jo shumicë. Në fakt nuk është diçka që nuk mund të dihet por normal që drejtorët e shkollave janë në dijeni saktë sa nxënës eventualisht kanë ngecë në arsim, por po ashtu me të drejtë e tha parafolësi që në këto rrethana pandemie është paksa problematike që të mund të marrim apo të kemi ndonjë informacion të saktë, ashtu siç nuk mund të ketë dalë ende as Drejtoria e Arsimit me informacione të sakta rreth kësaj çështje, sepse kjo ndërlihet edhe tek nxënësit e komunitetit shumicë mirëpo me fillimin e vitit të ri shkollor tani që do të filloj në shtator e që ndoshta në bazë të trendit të pandemisë mund të ndodhë që mësimi të filloj sërish nga distanca apo online siç po quhet, prandaj e potencova që Drejtoria e Arsimit mund t'i ketë të sakta të dhënat e tyre faktike dhe arsytet e ndërprerjes së mësimit eventual nga nxënësit qoftë të komuniteteve jo shumicë qoftë atyre shumicë e që në këtë formë pastaj bëhet edhe identifikimi i

tyre dhe shkaqeve të ndërprerjes së mësimi, qoftë për shkaqe ekonomike, qoftë sociale apo arsye tjera.

Sa kam informata, për gjithë ata nxënës që kanë qenë aktiv, viti shkollor nuk i është humbur askujt sepse ka qenë mësim online dhe nuk ka mundur askush të përcjellë askënd se a po përcjellë apo jo mësimin nga distanca/shtëpia, prandaj lidhur me këtë temë sërish po e ceku se pajtoj me parafolësit se kjo temë më mirë do të ishte të diskutohej në muajin shtator ku prezent do të e edhe ishte një zyrtar i DKA-së dhe do të kishim edhe informata më të sakta, më të detajuara rreth numri të nxënësve dhe çështje tjera relevante.

Pajtoj edhe me atë që parafolësja znj.Dorintina Hasani e tha se është mirë të ngritet si çështje dhe të mundohemi t'iu ndihmojmë me pajisje të teknologjisë gjithë atyre që nuk kanë mundësi për qasje në mësimin online, nëse veç fillon në këtë formë, pra në Kuvendin e Komunës të ngritet kjo çështje dhe brenda mundësive të ndahej një shumë e mjeteve buxhetore për sigurimin e pajisjeve për ata nxënës që nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin online.

znj.Valbone Kadriu - Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, theksoi, pajtoj që është dashur që rreth kësaj pike të ishte ndonjë zyrtar nga Drejtoria e Arsimit për të na jap informata më të sakta dhe më të detajuara mirëpo nuk di se Kryesuesja e këtij Komiteti kur e ka bërë rendin e ditës a ka pas komunikim dhe a ka ftuar dikë nga kjo Drejtori, andaj nuk di se çfarë mund të themi tjetër.

Meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën e konstatoj të përfunduar diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

2. Diskutim dhe gjetja e mundësive për fushatë ndërgjegjëse te Komunitetet jo shumicë për mbrojtjen nga Coronavirus Covid-19.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, lidhur me këtë temë nuk di saktësisht se çfarë është menduar kur është paraparë si temë nga ana e Kryesues së Komitetit e cila tani nuk është prezent, mirëpo mendoj se kjo çështja ka mundur të bëhet më herët sepse tani konsideroj se e gjithë popullata janë të vetëdijshëm dhe janë ndërgjegjësuar sa i përket covid-19 kështu që nuk ka nevojë më askush për një gjë të tillë, sepse tash po shihet numri i infektimeve dhe Komuna e Podujevës si komunë me një territor shumë të gjerë ka të prekur pothuajse në çdo fshat nga 1 apo 2-3 persona me covid-19, kështu që në këto momente ruajta nga mos infektimi është shumë e vështirë për të gjithë dhe këtë po e vërejmë secili prej nesh që nga rreth 450 testime që po bëhen në ditë po dalin pozitiv po thuajse më shumë se gjysma e tyre. Po ashtu çështja e ndërgjegjësimi është bërë dhe vazhdon të bëhet edhe nga mediat, andaj edhe pse kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë vetëm për ndërgjegjësimin e Komunitetit jo shumicë, mirëpo besoj që kur e gjithë popullata është e ndërgjegjësuar, shohin dhe dëgjojnë rreth koronavirusit covid-19 besoj që edhe Komuniteti jo shumicë është në dijeni për një gjë të tillë, kështu që nuk mendoj që do të ishte e nevojshme në këtë kohë ndonjë fushatë ndërgjegjëse rreth pandemisë, madje më e rëndësishme do të ishte të merremi me atë që është paraparë në pikën paraprake, konkretisht për identifikimin e atyre që kanë nevojë dhe kush ka mbete mbrapa me mësim ose diçka të ngjashme.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dëshiroj të potencoj se para rreth 1 muaji situata me covid-19 në Kosovë ka qenë më ndryshe, pajisjet mbrojtëse si maska etj. nuk i kanë mbajtur shumica e qytetarëve kurse tani kemi një ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve rreth masave mbrojtëse.

Duhet përsëritur Policia e Kosovës për punën e palodhshme që kanë bërë dhe që vazhdojnë ta bëjnë e që ka ndikuar shumë në vetëdijësimin e qytetarëve sa i përket respektimit të masave dhe rekomandimeve përkatëse, kështu që besoj se situata me covid-19 është e njëjtë për të gjithë.

znj.Valbone Kadriu - Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmërrur të tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, si qëndrim i Komitetit për Komunitete është se në këto rrethana nuk paraqitet nevoja të bëhet ndonjë fushatë ndërgjegjëse tek Komuniteti jo shumicë sa i përket respektimit të masave dhe rekomandimeve të institucioneve përkatëse vendore dhe ndërkombëtare sepse vazhdimisht është bërë thirrje dhe vazhdon të bëhet thirrje për një gjë të tillë, mandej kemi fushata të ndryshme nëpër rrjete sociale dhe pothuajse në të gjitha mediat, kështu që nuk e shohë të arsyeshme as unë vetë personalisht që të kemi grumbullime nëpër familje, lagje apo të ngjashme sepse të gjithë pothuajse janë të vetëdijshëm rreth kësaj çështje.

E konsideroj të mbyllur edhe këtë pikë të rendit të ditës.

3. Problemet e krijuara me rrjetin e kanalizimit ku jetojnë Komunitetet jo shumicë, rr.”Xhafer Meta”.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sot para se të vije në këtë takim disa banorë të lagjes në fjalë më kanë dërguar disa foto të cilat i posedoj këtu në telefon. Edhe pse jam në dijeni se ka pas disa punime në atë lagje në rrjetin e kanalizimit, mirëpo saktësisht nuk e di se çfarë është bërë mirëpo siç duket edhe në foto gjendja nuk është e mirë sepse është mbushur me ujë ajo lagje, mirëpo është dashur të kemi një informatë rreth kësaj çështje prej drejtorit z.Hamdi Jaha që ishte edhe pikë e rendit të ditës muajin a kaluar, përndryshe ne nuk kemi informata të mjaftueshme rreth punimeve dhe çështjeve tjera që ndërliken me këtë pikë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, çështja në fjalë ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit sepse kjo merret me kanalizime, trotuare etj të ngjashme, kurse Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit kryesisht ka infrastrukturën.

Po ashtu edhe për këtë pikë të rendit të ditës do të ishte mirë të ishte prezent një zyrtar i kësaj Drejtorie apo vetë drejtori i cili do të na ofronte informata të detajuara rreth çështjes së ngritur, e them këtë ngase kur nuk kemi informacione pastaj është paksa problem edhe të diskutohet për diçka por kompetentët është mirë të japin informata dhe sqarime të nevojshme ngase janë ata që kanë bërë projektin, janë komisioni mbikëqyrës i punimeve si dhe është edhe komisioni i pranimit të punëve, andaj në qoftë se një projekt nuk realizohet sipas përmasave të parapara atëherë menaxhimin e atij projekti normal që e kontrollon komisioni apo inxhinieri mbikëqyrës si dhe në qoftë se ka lëshime apo gabime në kuptimin e performancës në ato pika që do të duhej të kryhej projekti është komisioni i pranimit i cili pastaj mund të del me qëndrim rreth punimeve se a janë kryer sipas projektit apo jo.

Edhe për këtë pikë do të duhej të bëheshin konsultime me Drejtorinë përkatëse në mënyrë që të jetë ndokush prezent në takim për të na ofruar informacione më të sakta sepse problemi është që ne po diskutojmë mirëpo nuk jemi kompetentë në kuptimin profesional sa i përket kanalizimit në lagjen në fjalë, punimeve që janë kryer dhe çështje tjera përkatëse, prandaj kjo është ajo që unë e ceka në fillim që kur të bëhet është mirë të ketë komunikim me ZKKK-në si dhe një bashkëpunim dhe koordinim të mirë me Drejtorinë përkatëse dhe të jenë prezent drejtorët apo ndonjë zyrtar i Drejtorive përkatëse në mënyrë që pastaj të mund të debatohet dhe gjendjen mënyra dhe forma të gjetjes së zgjidhjeve për çështje të caktuara qoftë në arsim, shëndetësi, infrastrukturë dhe të tjera.

z.Bashkim Syla, theksoi, mendoj se do të ishte mirë që për këtë pikë e rendit të ditës të ishte prezent dikush nga Drejtoria përkatëse në mënyrë që të jap sqarime dhe përgjigje të nevojshme në mbledhjen e radhës së këtij Komiteti rreth projektit në fjalë, qoftë si informatë qoftë me prezencën e ndokujt, përndryshe pa qenë prezent nga Drejtoria përkatëse për informata rreth atij projekti ne vetëm mund të debatojmë kot.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës konsideroj se diskutimet përfunduan. Pas asaj që u tha nga parafolësit nuk kam çfarë të shtoj më shumë.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime

zëvendës kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/01-0042362/20

Podujevë,

05 gusht 2020

zëvendës kryesuese e Komitetit

valbona Kadriu-Podvorica_____

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu_____